



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/

Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

**RREGULLORE E BRENDSHME (MASHTI) NR. ^{18/22} /2022 PËR PARANDALIMIN E
KONFLIKTIT TË INTERESIT**

**INTERNAL REGULATION (MESTI) NO. ____ /2022 ON PREVENTION OF THE
CONFLICT OF INTEREST**

**UNUTRAŠNJI PRAVILNIK (MONTI) BR. ____ / 2022 O SPREČAVANJU
SUKOBA INTERESA**

<p>Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të nenit 20, paragrafit 3 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (Gazeta zyrtare nr. 5/27 prill 2018), si dhe nenit 8, paragrafit 1, nënparagrafit 1.4, nenit 14 paragrafit 1 nënparagrafit 1.7, shtojcës 1 pikës 7 të Rregullores (QRK) nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe Udhëzimit administrativ nr. 03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative (GZ, nr. 03/2013, dt. 16.05.2013), nxjerr:</p> <p style="text-align: center;">RREGULLORE E BRENDSHME PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT</p> <p style="text-align: center;">Neni 1 Qëllimi</p> <p>Kjo Rregullore e brendshme, ka për qëllim vendosjen e rregullave dhe procedurave të brendshme për parandalimin e konfliktit të interesit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (tani e tutje MASHTI) dhe institucionet në vartësi.</p>	<p>Ministry of Education, Science, Technology and Innovation, pursuant to Article 20, paragraph 3 of the Law no, 06 / L-011 on Prevention of Conflict of Interest in Exercising Public Function (Official Gazette no. 5, 27 September 2018), Article 8 paragraph 1, sub-paragraph 1.4, Article 14 paragraph 1 sub-paragraph 1.7, Annex 1 point 7 of Regulation (GRK) no. 02/2021 on areas of administrative responsibility of the Prime Minister’s Office and Ministries and the administrative instruction, no: 03/2013 on the standards for drafting normative acts (OG, no. 03/2013, dated 16.05. 2013), issue:</p> <p style="text-align: center;">INTERNAL REGULATION ON PREVENTION OF THE CONFLICT OF INTEREST</p> <p style="text-align: center;">Article 1 The purpose</p> <p>This Internal Regulation aims to establish internal rules and procedures for the prevention of conflict of interest in the Ministry of Education, Science, Technology and Innovation (hereinafter MESTI) and the subordinate institutions.</p>	<p>Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije. u skladu sa članom 20. stav 3. Zakona br. 06/L-011 o sprečavanju sukoba interesa u vršenju javne funkcije (Službeni glasnik br. 5/27. april 2018. godine), kao i člana 8. stav 1. podstav 1.4, člana 14. stav 1. podstav 1.7. Aneks 1 tačka 7 Uredbe (VRK) br. 02/2021 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstava kao i Administrativno uputstvo br. 03/2013 o standardima za izradu normativnih akata (SG br. 03/2013, od 16.05.2013), izdaje:</p> <p style="text-align: center;">UNUTRAŠNJI PRAVILNIK O SPREČAVANJU SUKOBA INTERESA</p> <p style="text-align: center;">Član 1 Cilj</p> <p>Ovaj unutrašnji pravilnik ima za cilj uspostavljanje unutrašnjih pravila i procedura za sprečavanje sukoba interesa u Ministarstvu obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije (u daljem tekstu MONTI) i podređenim institucijama.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 2 Fushëveprimi</p> <p>Dispozitat e kësaj Rregulloreje të brendshme janë të detyrueshme për të gjithë zyrtarët e MASHTI-it dhe zyrtarë tjerë të përcaktuar në këtë rregullore, nëse nuk parashihet ndryshe me dispozita tjera ligjore.</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Scope</p> <p>The provisions of this Internal Regulation are mandatory for all MESTI officials and other officials defined in this Regulation, unless otherwise provided by other legal provisions.</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Oblast delovanja</p> <p>Odredbe ovog unutrašnjeg pravilnika su obavezne za sve službenike MONTI-a i druge službenike definisane ovom uredbom, osim ako nije drugačije predviđeno drugim zakonskim odredbama.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Përkufizimet</p> <p>1. Për qëllim të kësaj Rregulloreje të brendshme, termet e mëposhtme kanë këtë kuptim:</p> <p>1.1. Zyrtari i MASHTI-t - përfshin të gjithë të punësuarit në MASHTI, institucionet tjera në vartësi dhe zyrtarët tjerë të përcaktuar në nenin 1;</p> <p>1.2. Interes publik — interesi material ose jomaterial i ligjshëm dhe i drejtë në dobi të qytetarëve;</p> <p>1.3. Interes privat i personit zyrtar — nënkupton çfarëdo përfitimi për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste;</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Definitions</p> <p>1. For the purposes of this Internal Regulation, the following terms have the following meanings:</p> <p>1.1. The MESTI official - includes all employees in MESTI, other subordinate institutions, and other officials defined in Article 1;</p> <p>1.2. Public interest: lawful and fair material or immaterial interest for the benefit of citizens;</p> <p>1.3. Private interest of the official person - means any benefit to the official person, its family, relatives, friends and persons or organizations with which he/she has had or has business relations;</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Definicije</p> <p>1. Za potrebe ovog nutrašnjeg Pravilnika izrazi u nastavku imaju sledeća značenja:</p> <p>1.1. Službenik MONTI-a - uključuje sve zaposlene u MONTI, drugim podređenim institucijama i druge službenike definisane članom 1;</p> <p>1.2. Javni interes - materijalni ili nematerijalni interes zakonit i pravičan u korist građana;</p> <p>1.3. Privatni interes službenog lica - podrazumeva svaku korist službenog lica, njegove porodice, rođaka, prijatelja i lica ili organizacija sa kojima je imao ili ima poslovne odnose;</p>

<p>1.4. Vendimmarrja - çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës, si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik;</p> <p>1.5. Zona e përgjegjësisë - përfshin detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit gjatë kryerjes së aktiviteve zyrtare;</p> <p>1.6. Punë sekondare- nënkupton punën dhe angazhimin që zyrtari i MASHTI-t dhe institucioneve tjera vartëse i kryen me pagesë, apo pa pagesë jashtë MASHTI-t;</p> <p>1.7. Konflikt interesi - rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare;</p> <p>1.8. Person i afërt me zyrtarin — bashkëshorti/ja ose personi që bashkëjeton. Të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime (p.sh. gjyshërit.</p>	<p>1.4. Decision-making - the last moment of the decision-making process during which the final content of the act or contract is decided, as well as those preliminary moments of decision-making which are essential and determining in which the participation, influence and attitude of the official determine the final content of the act or contract. and any action of the official in exercising public function;</p> <p>1.5. Area of responsibility - includes the duties and responsibilities of the officer while performing official activities;</p> <p>1.6. Secondary work-means the work and commitment that the MESTI official and other subordinate institutions performs with payment, or without being paid outside MESTI;</p> <p>1.7. Conflict of interest - a circumstance in which the official has a private interest, which affects, can affect or seems to affect the performance of its official duty with impartiality and objectivity;</p> <p>1.8. Person close to the official - spouse or cohabitant. Relatives in a straight line of blood without restrictions (eg grandparents, parents, children,</p>	<p>1.4. Odlučivanje – poslednji momenat u procesu odlučivanja tokom kojeg se odlučuje o konačnom aktu ili ugovoru, kao i oni prethodni momenti odlučivanja koji su suštinski i odlučujući u kojima je učešće, uticaj i stav službenika utvrđuje konačan sadržaj akta ili ugovora kao i svaku radnju službenika u vršenju javne funkcije;</p> <p>1.5. Oblast odgovornosti - obuhvata dužnosti i odgovornosti službenika tokom obavljanje službenih aktivnosti;</p> <p>1.6. Sekundarni posao podrazumeva rad i angazovanje koje službenik MONTI-a i druge podređene institucije vrše uz naknadu ili bez naknade van MONTI-a;</p> <p>1.7. Sukob interesa - okolnost u kojoj službeno lice ima privatni interes, koji utiče, može uticati ili izgleda da utiče u njegovom nepristrasnom i objektivnom vršenje njegove službene dužnosti;</p> <p>1.8. Lice blisko službeniku - supružnik ili vanbračni drug. Pravi srodnici bez ograničenja (npr. bake i dede, roditelji, deca, deca dece, ali ne</p>
---	--	--

<p>prindërit, fëmijët, fëmijët e fëmijëve, por jo vetëm), të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e tretë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin;</p> <p>1.9. Marrëdhënie kontraktuale — çdo marrëdhënie mallrash dhe shërbimesh në mes të institucioneve publike dhe operatorëve ekonomik, shitblerje të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, marrëdhënie punësimi, huamarrje, huadhënie, qiradhënie, qiramarrje, si dhe çdo raport tjetër i ngjashëm.</p> <p style="text-align: center;">Neni 4 Parimet e veprimit të zyrtarit të MASHTI-t dhe institucioneve tjera vartëse për parandalimin e konfliktit të interesit</p> <p>1. Çdo zyrtar është i obliguar që t' i zbatojë të gjitha detyrimet dhe instruksionet që parashihen me këtë rregullore, për të identifikuar, raportuar, parandaluar dhe shmangur konfliktin e interesit.</p> <p>2. Parimet e veprimit dhe mosveprimit të</p>	<p>children of children, but not only), relatives in the indirect line up to the fourth degree, adopter, adoptee, relative in the gender of affinity up to the third degree as well as any natural or legal person who has had or has a joint private property interest or non-property interest with the official.</p> <p>1.9. Contractual relationship - any relationship of goods and services between Public Institutions and Economic Operators, sale-purchase of movable and immovable property, employment relationship, borrowing, lending, renting, leasing, and any other similar relationship.</p> <p style="text-align: center;">Article 4 The action principles of the MESTI official and other subordinate institutions for the prevention of the conflict of interest</p> <p>1. Every official is obliged to implement all obligations and instructions, provided by this regulation, to identify, report, prevent and avoid the conflict of interest.</p> <p>2. The action and inaction principles of the</p>	<p>samo), srodnici u indirektnoj liniji do četvrtog stepena, usvojioci, usvojenici, srodnici u tazbini do trećeg stepena kao i svako fizičko ili pravno lice koje je koje je sa službenim licem imalo ili ima zajednički privatni imovinski ili neimovinski interes.</p> <p>1.9. Ugovorni odnos - svaki odnos ruba i usluga između javnih institucija i privrednih subjekata, kupoprodaja pokretne i nepokretne imovine, radni odnos, pozajmljivanje, davanje u zajam, iznajmljivanje, o i svaki drugi sličan odnos.</p> <p style="text-align: center;">Član 4 Principi aktivnosti službenia MONTI I druge podređene institucije za sprečavanje sukoba interesa</p> <p>1. Svaki službenik je dužan da primenjuje sve obaveze i instrukcije predviđene ovom uredbom, kako bi se identifikovao, izveštavao, sprečavao i izbegavalo sukob interesa.</p> <p>2. Principi delovanja i nedelovanja</p>
--	---	---

<p>zyrtarit, janë:</p> <p>2.1. Ushtron funksionin e tij në pajtim me ligjin, kodin përkatës të mirësjelljes dhe këtë Rregullore të brendshme;</p> <p>2.2. Duhet ta kryejë punën e tij me ndershmëri, integritet, ndërgjegje, paanshmëri, të ruaj autoritetin e institucioneve publike dhe me punën e tij të forcoj besueshmërinë e qytetarëve;</p> <p>2.3. Të veproj në mbrojtje të interesit publik dhe nuk ka të drejtë që interesin e tij privat ta vë para interesit publik;</p> <p>2.4. Të përgjigjet personalisht për veprimet e tij gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare;</p> <p>2.5. Të mos kryejë një veprim të kundërligjshëm apo edhe të ligjshëm gjatë ushtrimit të detyrës së tij zyrtare, me qëllim të marrjes së një përfitimi në kundërshtim me këtë rregullore për vete ose për një person apo subjekt tjetër;</p> <p>2.6. Për punën që kryen në ushtrimin e funksionit nuk ka të drejtë të kërkoj apo pranoj shpërblim/favor tjetër, si dhe ofrimin ose premtimin e shpërblimit,</p>	<p>official, are:</p> <p>2.1.Exercises its function in accordance with the law, the relevant code of conduct and this Internal Regulation;</p> <p>2.2.It must carry out its work with honesty, integrity, conscience, impartiality, maintain the authority of Public Institutions and with its work strengthen the credibility of citizens:</p> <p>2.3.To act in protecting the public interest and has no right to put its private interest before the public interest:</p> <p>2.4.To be personally responsible for its actions while exercising the official duty;</p> <p>2.5.Not to commit an illegal or even lawful act during the exercise of his official duty, in order to obtain a benefit in violation of this regulation for itself or for another person or entity;</p> <p>2.6.For the work performed in exercising the function, he/she has no right to request or accept any other reward / favor, as well as the offering</p>	<p>službenika su:</p> <p>2.1. Vrší svoju funkciju u skladu sa zakonom, odgovarajućim kodeksom ponašanja i ovaj interni pravilnik;</p> <p>2.2. Mora da obavlja svoj rad pošteno, sa integritetom, savešću, nepristrasnošću, da sačuva autoritet javnih institucija i sa svojim radom ojača kredibilitet građana:</p> <p>2.3. Da deluje u odbrani javnog interesa i nema pravo da svoj privatni interes stavi ispred javni interes:</p> <p>2.4. Da lično odgovori na njegove postupke tokom vršenja njegove službene dužnosti;</p> <p>2.5. Da ne počini nezakonito ili čak zakonito delo u vršenju njegove službene dužnosti, u cilju pridobijanja koristi koja je u suprotnosti sa ovim pravilnikom za sebe ili za određenu osobu ili drugi subjekt;</p> <p>2.6. Za rad koji obavlja u vršenju funkcije nema pravo da traži ili prima nagradu / prednost, kao i omogućavanje ili obećanje za nagradu, osim za naknadu</p>
--	---	--

<p>përveç kompensimit që i lejohet në bazë të dispozitave ligjore në fuqi;</p> <p>2.7. Të shmang konfliktin e interesit;</p> <p>2.8. Të mos përdor pozitën apo funksionin e vetë për të ti avancuar interesat e veta personale apo të personave të afërm.</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Veprimet e ndaluara për zyrtarin e MASHTI-t dhe institucioneve tjera vartëse</p> <p>1. Zyrtarit të MASHTI-t dhe institucioneve të përcaktuara në nenin 1, në lidhje me detyrën zyrtare, i ndalohen këto veprime:</p> <p>1.1. Të kërkojë apo pranoj dhuratë apo përfitim tjetër të padrejtë për vete apo personin tjetër, ose ofertë apo premtim për dhuratë, në mënyrë që zyrtari të veproj ose të mos veproj në kryerjen e detyrës së tij zyrtare;</p> <p>1.2. Të kërkojë, përvetësoj, pranoj shpërblime, dhurata, përfitime apo shërbime të padrejta për vete ose për tjetrin, si kompensim për përcaktimin e</p>	<p>or promising the reward, except for the compensation that is allowed to him/her based on the legal provisions in force;</p> <p>2.7.To avoid the conflict of interest;</p> <p>2.8.Not to use its position or function to advance its own personal interests or those of relatives.</p> <p style="text-align: center;">Article 5 Prohibited actions for the MESTI official and other subordinate instituions</p> <p>1.The following actions which are defined in article 1, in relation to the official duty are prohibited for the MESTI official and institutions:</p> <p>1.1.To seek or accept a gift or other unfair benefit for itself or another person, or an offer or promise of a gift, so that the official may or may not act in performing its official duty;</p> <p>1.2.To seek, embezzle, accept rewards, gifts, benefits or services unfair benefit for itself or to another, as compensation for its determination in decision-</p>	<p>dozvoljenu prema važećim zakonskim odredbama;</p> <p>2.7. Da izbegne sukob interesa;</p> <p>2.8. Da ne koristi sopstveni položaj ili funkciju da bi unapredio svoje lične interese ili interese rođaka.</p> <p style="text-align: center;">Član 5 Radnje zabranjene za službenika MONTI-a i druge podređene institucije</p> <p>1.Službeniku MONTI i institucije utvrđene u članu 1, u vezi službene dužnosti, zabranjeni su sledeće radnje:</p> <p>1.1 Da traže ili prima poklone ili druge koristi za sebe ili drugu osobu ili ponudu ili obećanje za poklon kako bi službenik delovali ili ne delovao u vršenju svoje službene dužnosti;</p> <p>1.2. Da traži, usvoji, prima nagrade, poklone, koristi ili nepravedne usluge za sebe ili drugog, kao naknadu za njegovu odluku;</p>
---	--	--

<p>tij në vendimmarrje;</p> <p>1.3. Të ndikojë në vendimin e ndonjë zyrtari për arsye të përfitimit të padrejtë për vete apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik;</p> <p>1.4. Të premtojë, ofroj ose jap dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër të padrejtë në këmbim të ndonjë dhurate apo përfitimi të padrejtë, real ose të premtuar;</p> <p>1.5. Të ndikojë në kontraktimin, dhënien e punëve apo furnizimeve publike për përfitime të padrejta për vete apo të çdo personi tjetër të përcaktuar në nenin 3, nënparagrafi 1.3;</p> <p>1.6. Të shfrytëzojë informatat e besueshme që i ka në dispozicion apo të marra në mirëbesim në ushtrimin e detyrës zyrtare, për përfitime të padrejta për vete apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik;</p> <p>1.7. Të ndërmarrë veprime, të cilat do t'i përshtaten interesit personal të tij apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik;</p> <p>1.8. Të ndërmarrë veprime, të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten apo do të favorizonin interesin privat të ndonjë personi tjetër në dëm të interesit publik;</p>	<p>making;</p> <p>1.3.To influence the decision of an official due to unfair benefit for itself or any other natural and legal person;</p> <p>1.4.To promise, offer or give a gift or any other unfair benefit in exchange for any unfair, real or promised gift or benefit;</p> <p>1.5.To influence the contracting, provision of works or public supplies for unfair benefits for himself or any other person defined in article 3, subparagraph 1.3;</p> <p>1.6.To use reliable information available or obtained in good faith in exercising the official duty, for unfair benefits for itself or any other natural and legal person;</p> <p>1.7.To take actions that will suit its personal interest or that of any other natural or legal person;</p> <p>1.8.To take actions that will suit or favor in any way the private interest of another person at the public interest detriment;</p>	<p>1.1. Uticati na odluku bilo kog zvaničnika iz razloga nepravedne koristi za sebe ili bilo koje drugo fizičko i pravno lice;</p> <p>1.2. Da obeća, ponudi ili daje poklone ili bilo koju drugu nepravednu korist u zamenu za bilo koji poklon ili nepravednu ili obećanu korist;</p> <p>1.3. Da utiče na ugovaranje, dodeljivanje poslova ili javnih nabavki za nepravedne koristi za sebi ili bilo koje drugo lice utvrđeno članom, podstav 1.3;</p> <p>1.4. Da koristili pouzdane informacije koje ima na raspolaganju ili dobijene na poverenju u vršenje svoje službene dužnosti, za nepravedne koristi za sebe ili bilo koje drugo fizičko i pravno lice;</p> <p>1.5. Da preduzme radnje koje će odgovarati njegovom lično interesu ili drugom fizičkom i pravnom licu;</p> <p>1.6. Da preduzme radnje, koje bi na neki način odgovarale ili favorizovale privatne interese bilo koje druge osobe na štetu od javnog interesa;</p>
---	--	---

<p>1.9. Të keqpërdorë ose të lejojë që të përdoren pasuritë zyrtare të MASHTI-t, përfshirë dokumentet zyrtare, platformat elektronike etj, për ndonjë qëllim tjetër që nuk përputhet me ushtrimin e detyrës zyrtare dhe në pajtim me ligjin.</p> <p>1.10. Nuk mund të jetë përfitues i ndonjë nga format e mbështetjes financiare të realizuara nga buxheti i MASHTI-t ose të menaxhuara nga MASHTI.</p> <p>2. Zyrtari i MASHTI-t dhe institucioneve tjera vartëse, nuk mund të angazhohet në punë jashtë institucionit pa ju lejuar nga zyrtari më i lartë administrativ.</p> <p>3. Zyrtari i MASHTI-t dhe institucioneve tjera vartëse, nuk lejohet të angazhohet në punë jashtë institucionit që janë zonë e përgjegjësisë në institucione arsimore në fushën të cilën është i angazhuar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 6 Aktivitetet e lejuara për zyrtarin e MASHTI-t</p> <p>Zyrtari i MASHTI-t, mund të angazhohet në punë sekondare në fushat, si: shkencë,</p>	<p>1.9.To abuse or to allow the use of official assets of MESTI, including official documents, electronic platforms, etc., for any other purpose that does not comply with the exercise of official duty and in accordance with the law.</p> <p>1.10.It cannot be a beneficiary of any form of financial support realized from MESTI's budget or managed by MESTI</p> <p>2.The MESTI official and other subordinate institutions cannot be engaged in work outside the institution without the permission of the senior administrative officer.</p> <p>3.The MESTI official and other subordinate institutions is not allowed to be engaged in work outside the institution, which are areas of responsibility in educational institutions in the field in which he is engaged.</p> <p style="text-align: center;">Article 6 Permitted activities for the MESTI official</p> <p>The MESTI official can be engaged in secondary work in areas such as: science,</p>	<p>1.7. Da zloupotrebi ili dozvoli da se koristi službena imovina MONTI-a, uključujući zvanična dokumenta, elektronske platforme itd., u bilo koju drugu svrhu koja se ne uklapa sa obavljanje službene dužnosti i u skladu sa zakonom.</p> <p style="text-align: center;">Ne može biti korisnik nijednog od oblika finansijske podrške koja se realizuje iz budžeta MONTI-a ili kojim menadžira MONTI-i.</p> <p>2. Službenik MONTI-a i druge podređene institucije, ne može se baviti poslom izvan institucije bez odobrenje nadređenog administrativnog službenika.</p> <p>3. Službenik MONTI-a i druge podređene institucije, ne sme da se angažuje na poslovima van institucija koje su u zoni odgovornosti u obrazovnim institucijama u oblasti u kojoj je angažovan.</p> <p style="text-align: center;">Član 6 Dozvoljene aktivnosti za službenika MONTI-a</p> <p>Službenik MONTI-a može biti angažovan na sekundarnim poslovima kao što su:</p>
--	--	--

<p>sport, seminare, trajnime, hulumtime, borde në ndërmarrje publike, ndërmarrje shoqërore dhe organizata buxhetore, kulturë dhe veprimtari humanitare, si dhe institucione të tjera private të cilat nuk bien në përgjegjësitë e tij të detyrave zyrtare. Këto aktivitete mund të ushtrohen nga zyrtari, nëse nuk është në zonën e përgjegjësive dhe nuk është pjesë e vendimmarrjes.</p> <p style="text-align: center;">Neni 7 Angazhimi në punë jashtë institucionit</p> <p>1. Secili zyrtar i MASHTI-t, i cili dëshiron të angazhohet në punë sekondare, paraprakisht duhet të bëjë kërkesë me shkrim, duke plotësuar aplikacionin për punë sekondare (shtojca nr. 1).</p> <p>2. Aplikacioni duhet të jetë i plotësuar me komentim të drejtpërdrejtë, brenda dy (2) ditë pune nga data e pranimit të kërkesës për punë sekondare.</p> <p>3. Aplikacioni i plotësuar dhe i kompletuar duhet të dorëzohet në zyrën e zyrtarit kryesor administrativ në formë fizike (përmes arkivit) apo në formë elektronike, para se të fillohet puna sekondare.</p> <p>4. Zyra e zyrtarit kryesor administrativ,</p>	<p>sports, seminars, training, research, boards in Publicly Owned Enterprises, Socially Owned Enterprises and Budget Organizations, culture and humanitarian activities, as well as other private institutions which do not fall under its responsibilities of official duties. These activities can be exercised by the official, if he/she is not in the area of responsibility and is not part of the decision-making.</p> <p style="text-align: center;">Article 7 Engagement in work outside the institution</p> <p>1. Each MESTI official who wants to be engaged in secondary work, must make a written request in advance, filling out the application for secondary work (Annex no. 1).</p> <p>2. The application must be completed with the comment of the direct supervisor, within two (2) working days from the date of receipt of the request for secondary work.</p> <p>3. The completed application must be submitted to the office of the Chief Administrative Officer in physical form (through the archive) or in electronic form, before secondary work begins.</p> <p>4. The Office of the Chief Administrative</p>	<p>nauka, sport, seminari, obuka, istraživanje, odbori u javnim preduzećima, društvenim preduzećima i budžetskim organizacijama, kulture i humanitarne aktivnosti, kao i druge privatne institucije koje ne potpadaju pod njegove službene dužnosti. Ove aktivnosti može obavljati službeno lice, ako nije u zoni odgovornosti i ne učestvuje u odlučivanju.</p> <p style="text-align: center;">Član 7 Bavljenje poslovima van institucije</p> <p>1. Svaki službenik MONTI-a koji želi da se bavi sporednim poslovima, prethodno mora da podnese pismeni zahtev, popunjavanjem aplikacije za sporedni posao (Aneks br. 1).</p> <p>2. Aplikacija mora biti popunjena sa komentarom neposrednog rukovodioca, u roku od dva (2) radna dana od dana prijema zahteva za sporedni posao.</p> <p>3. Popunjena i kompletirana aplikacija se mora predati kancelariji glavnog administrativnog službenika u fizičkom obliku (preko arhive) ili elektronskim putem, pre nego što započne sporedni posao.</p> <p>4. Kancelarija glavnog administrativnog</p>
---	--	---

<p>brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike nga data e pranimit të kërkesës për punë sekondare, shqyrton dhe vendos për kërkesën e aplikuesit.</p> <p>5. ZKA refuzon kërkesën për angazhim në punë sekondare, në rastet kur:</p> <p>5.1. Kërkesa nuk është e kompletuar;</p> <p>5.2. Angazhimi në punë sekondare bie ndesh me legjislacionin për konflikt të interesit;</p> <p>5.3. Zyrtari ka përfunduar një detyrë zyrtare brenda dy (2) viteve tek subjekti në të cilin dëshiron të angazhohet në punë sekondare, apo bie në zonën e përgjegjësisë.</p> <p>6. Leja nga ZKA për punë sekondare lëshohet për një afat të caktuar deri në 3 vite me mundësi rishikimi.</p> <p>7. Përjashtim nga paragrafi 7 i këtij neni, leja për punë sekondare e lëshuar nga MASHTI mund të ndërpritet në çdo kohë nëse konstatohet se angazhimi i tillë bie në kundërshtim me rregullat e përcaktuara me këtë Rregullore të brendshme dhe legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Officer, within fifteen (15) calendar days from the date of receipt of the request for secondary work, reviews and decides on the applicant's request.</p> <p>5.CAO rejects the request for engagement in secondary work, in cases when:</p> <p>5.1.The request is not completed;</p> <p>5.2.Engagement in secondary work is in contradiction to the legislation for the conflict of interest;</p> <p>5.3.The official has completed an official duty within two (2) years to the entity in which he/she wants to be engaged in secondary work, or falls into the area of responsibility.</p> <p>6. The permit from the CAO for secondary work is issued for a fixed period of up to 3 years with the possibility of review.</p> <p>7.Exception from paragraph 7 of this article, the secondary work permit issued by MESTI can be terminated at any time if it is found that such engagement is contrary to the rules set out in this Internal Regulation and legislation in force.</p>	<p>službenika, u roku od petnaest (15) kalendarskih dana od dana prijema zahteva za sekundarni rad, razmatra i odlučuje o zahtevu podnosioca zahteva.</p> <p>5. GAS odbija zahtev za angažovanje u sporednim poslovima, u slučajevima kada:</p> <p>5.1.Zahtev nije kompletiran;</p> <p>5.2.Angažovanje u sekundarnom poslu je u sukobu sa zakonima o sukobu interesa;</p> <p>5.3. Službenik je završio službenu dužnost u roku od dve (2) godine kod subjekta u kome želi da se bavi sporednim poslovima, ili spada u zoni odgovornosti.</p> <p>6. Dozvola GAS za sekundarni rad se izdaje na određeno vreme do 3 godine sa mogućnošću preispitivanja.</p> <p>7. Izuzetak iz stava 7 ovog člana, dozvola za sekundarni rad izdata od strane MONTI može se ukinuti u bilo kom trenutku ako se utvrdi da je takvo angažovanje u suprotnosti sa pravilima utvrđenim ovim Poslovníkom i važećim zakonom.</p>
---	---	--

<p>8. Lidhur me vendimin e ZKA, pala e pakënaqur ka drejtë ankese sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 8 Obligimi për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit</p> <p>1. Zyrtari i MASHTI, ka për obligim të parandaloj dhe të zgjidh vetë në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit ndërmjet interesave të tij publike dhe private.</p> <p>2. Zyrtari i MASHTI, në rast se ka dyshime apo konstaton se konflikti i interesit ka lindur ose mund të lindë, duhet të këshillohet dhe të informoj sa më parë mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë apo ZKA-në. Gjatë kësaj kohe, zyrtari i MASHTI duhet të pezullojë të gjitha veprimet që ndërlidhen me këtë çështje deri në vendimin përkatës në lidhje me rastin.</p> <p>3. Çdo mbikëqyrës i drejtpërdrejtë ndërmerr masat e nevojshme të përcaktuara në këtë rregullore për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit.</p> <p>4. Në rast se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë nuk është në gjendje të vlerësojë ekzistimin e konfliktit të interesit, i drejtohet organit kompetent brenda në MASHTI dhe në raste</p>	<p>8.Regarding the decision of the CAO, the dissatisfied party has the right to appeal according to the legislation in force.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 Obligation to prevent and resolve conflicts of interest</p> <p>1. The MESTI official has the obligation to prevent and resolve in the most effective way possible, any situation of conflict between its public and private interests.</p> <p>2. The MESTI official, in case there are doubts or ascertains that the conflict of interest has arisen or may arise, should be advised and informed as soon as possible by the direct supervisor or the CAO. During this time, the MESTI official must suspend all actions related to this issue until the relevant decision regarding the case.</p> <p>3.Each direct supervisor should take all necessary measures defined in this regulation to prevent and resolve cases of conflict of interest.</p> <p>4.In case the direct supervisor is not able to assess the existence of a conflict of interest, is addressed to the competent body within MESTI and in special cases it can be</p>	<p>8. U vezi sa odlukom GAS, nezadovoljna strana ima pravo žalbe u skladu sa zakonima na snazi.</p> <p style="text-align: center;">Član 8 Obaveza za sprečavanje i rešavanja sukoba interesa</p> <p>1. Službenik MONTI-a je obavezan sam da spreči i reši na najefikasniji mogući način svaku situaciju sukoba između njegovih javnih i privatnih interesa.</p> <p>2. Službenik MONTI, u slučaju da postoje sumnje ili utvrdi da je sukob interesa nastao ili bi mogao nastati, treba da bude posavetovan i obavešten što je pre moguće od strane direktnog nadzornika ili GAS. Za to vreme, službenik MONTI-a mora da obustavi sve radnje u vezi sa ovim pitanjem do donošenja relevantne odluke u vezi sa slučajem.</p> <p>3.Svaki neposredni nadzornik preduzima neophodne mere utvrđene ovom uredbom da spreči i reši slučajeve sukoba interesa.</p> <p>4.U slučaju da neposredni rukovodilac nije u mogućnosti da proceni postojanje sukoba interesa, obraća se nadležnom organu unutar MONTI-a i u posebnim</p>
--	--	---

